

# OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE 2016 KOMUNA E PRISHTINËS

Data e dorëzimit të raportit:	<b>07.10.2016</b>				
Emri i komunës	Komuna e Prishtinës				
Emri i Kryetarit të Komunës	Shpend Ahmeti				
Emri i Zyrtarit Komunal për IE :	Ajshe Bërveniku				
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:ajshe.berveniku@rks-gov.net">ajshe.berveniku@rks-gov.net</a>				
	<b>Objektivi Strategjik duke u trajtuar</b>	<b>Drejtoritë përgjegjëse komunale</b>	<b>Pyetjet lidhur me zbatimin e aktiviteteve gjatë periudhës së raportimit</b>	<b>Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit ( <b>Janar - Shtator 2016</b>)</b>	<b>Sfidat për zbatim</b>

## 1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE

	<b>1. Administrata publike</b>				
	1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	<b>Zyra e personelit</b>	<p>1. A është hartuar programi i trajnimeve për komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura në komunën tuaj dhe cilat janë temat e trajnimeve?</p> <p>3. Sa është numri i zyrtarëve të komunës që kanë marrë pjesë në</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës, ka bashkëpunuar me DASHC/MAP rreth programit të trajnimit të IKAP për shërbimin civil dhe një numër i propozimeve tashmë janë pjesë e programit të IKAP;</p> <p>2. Gjatë nperiudhës raportuese <b>Janar - Shtator 2016</b> numri i trajnimeve të mbajtura në komunë është 6 (gjashtë). Komuna e Prishtinës ka marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar IKAP dhe</p>	

			trajnime?	DASHC/MAP. Në periudhën raportuese zyrtarët komunal, ndër të tjera kanë marrë pjesë në këto tema: Lidershipi dhe Menaxhimi; Zhvillimi Ekonomik Lokal; Monitorimi dhe Vlerësimi i Projekteve; Menaxhimi me Dokumente Arkivore; Planifikimi i Personelit; Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;	
	1.2.Të zbatohet legjislacioni dhe politikat për reformën e administratës publike	<b>Drejtoria e Administratës/Zyra e personelit</b>	1.A është përgatitur Katalogu i vendeve të punës në Shërbimin Civil në komunën tuaj?	3. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b> numri i zyrtarëve të komunës që kanë marrë pjesë në trajnime është 20;	
	1.3.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal	<b>Zyra për Informim</b>	1. Sa fushata vetëdijësuese ka organizuar komuna juaj për rëndësinë e shfrytëzimit të shërbimeve publike?  2.Sa është numri i	1. Në Janar 2016, Kryetari i Komunës ka marrë Vendim për organizimin e ri të administratës komunale. Ky Vendim, pjesë e të cilit janë edhe pozitat e administratës komunale është bazuar në tërësi në emërtimin e ri të pozitave të parapara me Katalogun e ri të vendeve të punës;	
				1. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b> janë mbajtur 5 fushata vetëdijësuese. 1. Për Riciklimin e Mbeturinave; 2. Mbrojtjen e Ambientit dhe 3. Eficiencë të Energjisë; 4.Pagesën e Tatimit në Pronë; si dhe 5.Qendra për Këshillim ne karriere;	

			<p>kërkesave për qasje në dokumente publike?</p> <p>3. A janë publikuar në ueb faqen e komunës tuaj të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e komunave në gjuhët zyrtare?</p> <p>4.Sa është numri i konsultimeve publike?</p> <p>5. Sa është numri i takimeve publike me qytetarë ?</p>	<p>2. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b>, numri i kërkesave për qasje në dokumente publike është 122;</p> <p>3. Po, të gjitha aktet e nxjerra nga organet komunale janë të publikuara në gjuhët zyrtare;</p> <p>4. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b>, në komunë janë mbajtur 2 konsultime publike, për shqyrtimin e draft-akteve komunale;</p> <p>5. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b>, janë organizuar 22 diskutime publike;</p>	
1.4.Të zbatohet në mënyrë sistematike rekrutimi i stafit civil i cili është bazuar me ligj	<b>Drejtoria e Administratës/Zyra e personelit</b>	<p>1. Çfarë përpjekje dhe veprime ka ndërmarrë Komuna që Komunitetet jo-shumicë të përfaqësohen në mënyrë adekuate në institucionet publike?</p> <p>2. Sa është numri i të punësuarave të komuniteteve jo shumicë</p>	<p>1.Në Maj 2016, është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosovo) për implementimin e Projektit: <b>“Përvetësimi i Gjuhëve Zyrtare për Zyrtarët Komunalë në Kosovë 2016”</b> në Komunën e Prishtinës;</p> <p>2. Numri i të punësuarave të</p>		

			në institucionet publike?	komuniteteve jo shumicë në administratën e Komunës, si shërbyes civil është 9 (nëntë);	
	<b>2. Avokati i Popullit</b>				
2.1.Të përmirësohen kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit	<b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</b>	1.A janë të qasshme për personat me aftësi të veçanta, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet lokale?	1. Po. Avokati i popullit në Komunë ka objekt të veçantë;		
2.2.Të zbatohen rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit	<b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</b>	1. Sa është numri i kërkesave/rekomandimeve të cilat Komuna i ka pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit?  2.Sa përgjigje pozitive i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?	1. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b> , në zyrën për Shërbim me qytetarë janë pranuar 13 kërkesa, 10 nga to i janë drejtuar Kryetarit të Komunës;  2. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b> , ka ndërmarrë veprime konkrete për 2 (dy) nga këto kërkesa;		

			<p>3.Sa përgjigje negative i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?</p> <p>4. Sa kërkesa/rekomandime janë në proces të shqyrtimit?</p>	<p>3. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b>, komuna e Prishtinës nuk ka pasur mundësi të ndikoj tek 1 (një) kërkesë, e cila ka qenë për emërtimin e rrugëve, proces ky i cili është përfunduar;</p> <p>4. <b>Janar - Shtator 2016</b>, në proces të shqyrtimit komuna e Prishtinës ka 7 (shtatë) kërkesa të Avokatit të Popullit;</p>	
	<b>3.Shoqëria civile</b>				
<p>3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile</p>		<p><b>Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim te Qëndrueshëm Ekonomik/Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kultures dhe Drejtoria e Shendetesise</b></p>	<p>1.Sa ka ndarë buxhet komuna për të financuar aktivitetet e OSHC-ve?</p> <p>2. Sa është numri i projekteve dhe shuma e mjeteve financiare të ndara për OJQ-të?</p>	<p>1. Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të OJQ-ve, komuna ka ndarë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 806 810 €;</p> <p>2. Në periudhën <b>Janar - Shtator 2016</b>, numri i projekteve është 6. Ndërsa shuma e ndarë është 332.165.00 euro; <u>(Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</u> ka ndarë rreth 290.000 mbështeten edhe OJQ te cilat konkurrojnë; <b>Drejtoria e Arsimit</b> ka ndarë subvencione për organizatat të ndryshme jo qeveritare si: a) Për Organizatën Jo - Qeveritare "Toka" ka ndarë 4,100.00 €; b) Për institucionet parashkollore me komunitet në bazë janë ndarë</p>	

				<p>këto mjete financiare: "Shtëpia Magjike" 20,283.00 €;  "Ngjyrat" 36,621.00 €;  "Botanika" 14,240.00 €;  c) Encompass-ATOMI janë ndarë 3,000.00 €.  d) SOS Kopshti – QS Edukative janë ndarë 3,100.00 €;  e) Kopshti "Shkronjat"- janë ndarë 2,200.00 €;  f) Bursat për student – janë ndarë 63,500.00 €;  Në total Drejtoria e Arsimit ka ndarë 147,044.00 € subvencione;</p>	
<b>4.Lufta kundër korrupsionit</b>					
4.1.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit	<b>Kordinatori i Sekretariatit/Kuvendi i Komunës</b>	<p>1. Sa është numri i personave zyrtar që deklarojnë pasurinë tek AKK?</p> <p>2. Sa është numri i personave zyrtar që nuk e deklarojnë pasurinë tek AKK?</p> <p>3. Sa është numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal dhe anëtarët e kuvendit të komunës me rastin e marrjes së vendimeve?</p>	<p>1. Numri i personave zyrtar që deklarojnë pasurinë është 76;</p> <p>2. Në komunë nuk ka asnjë zyrtar që nuk e deklaron pasurinë, që me ligj është i detyruar ta deklaroj;</p> <p>3. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016, nuk</b> kemi asnjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal apo anëtarët e Kuvendit të Komunës;</p>		

<p>4.2.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;</p>	<p><b>Kordinatori i Sekretariatit/Kuvendi i Komunës</b></p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit Komunal kundër Korrupsionit?</p> <p>2.A ka komuna juaj zyrtar që raporton për zbatimin e Planit të Veprimit Komunal kundër Korrupsionit?</p> <p>3.Sa është numri i raporteve të publikuara mbi monitorimin e zbatimit e Planit të Veprimit Kundër Korrupsion?</p>	<p>1. Po, Komuna e Prishtinës në fillim te vitit 2014 ne bashkëpunim me UNDP-ne ka hartuar Planin e Integritetit 2014-2016;</p> <p>2. Jo, komuna ende nuk e ka zyrtarin që raporton për zbatimin e Planit e Veprimit Komunal kundër Korrupsionit;</p> <p>3.Ky raportim përfshihet ne raportin e përgjithshëm te Komunës se Prishtinës i cili publikohet çdo vit dhe gjendet ne webfaqen e Komunës;</p>	
<p><b>5.Punët e brendshme dhe lufta kundër krimit të organizuar</b></p>				
<p>5.1.Ri-pranimi/ri-integrimi</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1.A është rritur kapaciteti i komunave për të menaxhuar në mënyrë efikase riintegrimin?</p>	<p>1. Riintegrimi i personave të riatdhesuar procedohet përmes ZKKK-së, në Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR) janë të angazhuar zyrtarë nga secila Drejtori dhe zyre (si NJDNJ dhe zyrtarja për Integrim Evropian);</p>	
<p><b>6.Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</b></p>				

6.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut

**Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

1.Sa është numri i aktiviteteve të komunës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut, si dhe cila është natyra e aktiviteteve?

2.A është hartuar rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?

3.Sa është numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për pakon ligjore për të drejtat e njeriut?  
(Ligji nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit (LAP), Ligji nr. 05/L -020 për barazi gjinore (LBGJ) dhe Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi

4. A është përfshirë komponentii të drejtave të njeriut në programin e trajnimeve për shërbyesit civil në komunën tuaj?

1. Gjatë periudhës **Janar - Shtator 2016** Komuna e Prishtinës ka mbajtur 8 (tetë) aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke promovuar zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut; natyra e aktiviteteve është promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, standardet ndërkombëtarë, Politikat, Strategjitë dhe Planet e veprimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës.

2. Të gjitha aktivitete i realizojmë pa kosto buxhetore për arsye se nuk kemi buxhet;

2. Jo, Komuna e Prishtinës ende nuk e ka hartuar Rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;



				<p>3. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b>, janë mbajtur 3 (tri) trajnime në përputhje me Ligjin, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (LAP), Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore (LBGJ) dhe Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe kemi punuar në hartimin e rregullores së përshkrimit të vendit të punës për zyrtaret për mbrojtjen nga diskriminimi ,organizuar nga zyra për qeverisje të mirë;</p> <p>4. Jo, nuk është përfshirë komponenti i të drejtave të njeriut në programin e trajnimeve për shërbyesit civil;</p>	
	6.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	<b>Zyra për Barazi Gjinore</b>	1.A është krijuar një sistem uniform i bazës së të dhënave të mbledhjes së rregullt të të dhënave mbi rastet e dhunës në baza gjinore në komunën tuaj?	1. Megjithëse nuk është krijuar një bazë e të dhënave përkatëse, komuna ka formuar Këshillin komunal kundër dhunës ku raportohen rastet dhe mbahen statistikat;	

6.3. Të drejtat e fëmijëve	<p><b>Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim te Qëndrueshëm Ekonomik</b></p>	<p>1. Cilat veprime janë ndërmarrë për të ngritur kapacitetin e koordinatoreve komunal për të drejtat e fëmijëve?</p> <p>2. A ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm komuna për të kryer në mënyrë të duhur këtë detyrë?</p> <p>3. Cilat janë vështirësitë e komunës tuaj për zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve?</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës nuk ka koordinator te veçantë për të drejtat e fëmijëve;</p> <p>2. Po por duke pasur parasysh qe buxheti i komunës është shume i ulet ne krahasim me kërkesat për këtë ndahet një shumë tepër e vogël;</p> <p>3. Mungesa e buxhetit dhe stafit te kualifikuar;</p>	
6.4. Të fuqizohet roli dhe pozita e femrës në shoqëri	<p><b>Zyra për Barazi Gjinore</b></p>	<p>1. Sa është numri i përfaqësimit të grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës ( p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)?</p> <p>2. Sa është numri total i përfaqësimit të grave në komunë, duke përfshirë administratën dhe Kuvendin e Komunës?</p>	<p>1. Numri i përfaqësimit të grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet janë 44 (dyzet e katër);</p> <p>2. Numri i përfaqësimit të femrave në komunë është gjithsej 236, (në Administratë janë 236, ndërsa në Kuvendin e Komunës janë 19 femra);</p>	

6.5.Zbatimi i të drejtave pronësore	<b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore</b>	1. Çfarë veprime ka ndërmarrë komuna e juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave?	1. Në rastin e regjistrimit të pronësisë së përbashkët të bashkëshortëve, bashkëshortët do paguajnë me vendimin e ri bashkërisht vetëm për një njësi; Gjithashtu me hyrjen në fuqi të UA Nr. 03/2016 është duke u zbatuar dhe i njoftojmë palët lidhje me këtë të drejtë;	
6.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore	<b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</b>	1.Sa raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?  2.. A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat jo - shqip folëse përmes linjës së ndihmës kundër trafikimit dhe kundër dhunës në familje?	1. Gjatë periudhës raportuese <b>Janar - Shtator 2016</b> , janë 4 (katër) fëmijë ku QPS (Qendra për Punë Sociale) është kujdesur;  2. Gjatë periudhës <b>Janar - Shtator 2016</b> , nuk është ndërmarr asnjë veprim i tillë, për asrye se linja e ndihmës është në nivel qendror e jo lokal;	
6.7.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal	<b>Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim te Qëndrueshëm Ekonomik/ Zyrës Komunale për</b>	1.A ka ndarë komuna juaj buxhet për mbrojtjen e komuniteteve pakicë?Nëse po, sa është buxheti?	1. Po, buxheti i ndarë për vitin 2016, për mbrojtjen e komuniteteve pakicë është 102.408.00 Euro;	

		<b>Komunitete dhe Kthim</b>			
	6.8.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve	<b>Zyra ligjore/Zyra informimit</b>	<p>1.A ka komuna juaj rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare?</p> <p>2.A është rekrutuar stafi i nevojshëm dhe profesional për përkthim?</p> <p>3. Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët që përdoren nga komunitetet pakicë?</p>	<p>1. Po, komuna e ka Rregullorën për përdorimin e gjuhëve zyrtare;</p> <p>2. Janë të angazhuar 3 përkthyes shqip – serbisht si dhe 1 përkthyes i gjuhës angleze;</p> <p>3. Komuna e ka përkthyesin, ka rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe në ueb-faqen e komunës publikohen dokumente në gjuhët zyrtare që përdoren në Komunë;</p>	
	<b>7.Mbrojtja dhe promovimi trashëgimisë kulturore</b>				

7.1. Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

**Drejtoria e Urbanizmit/Drejtoria e Inspektionit**

1. A ka komuna juaj Plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore?

2. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?

3. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?

4. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse?

5. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë në relacion me mirëmbajtjen e tërësive të Kishës Ortodokse?

1. Jo. Komuna nuk ka ende ndonjë plan specifik për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;

2. Gjatë periudhës **Janar - Shtator 2016**, nuk ka ndërtime pa leje në zonat e mbrojtura;

3. Gjatë periudhës **Janar - Shtator 2016**, pasi që nuk ka pasur as shkelje të tilla, nuk është asnjë masë eventuale. Në raste kur haset në ndërtime ilegale në zonat e mbrojtura, veprohet në përputhje me ligjin e ndërtimit dhe Inspektionit;

4. Jo, kjo nuk në kompetencë të inspektionit komunal. Komuna nuk ka asnjë informate te vetme se kush bene monitorimin e sigurisë apo instalimin e kamerave te sigurisë;

5. Jo, komuna Prishtinës nuk ka nënshkruar asnjë memorandum të tille përderisa Komuna nuk ka informatat e nevojshme për Kishën;

	7.2.Ndërmarrja e aktiviteteve për të përmirësuar koordinimin mes ministrive (MMPH, MKRS dhe MAPL) dhe për të rritur koordinimin në mes të këtyre ministrive dhe administratave komunale. Planet konkrete për aktivitete të ardhshme.	<b>Zyra e Kryetarit/Zyra komunale për Integrim Evropiane</b>	1.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë komuna për të përmirësuar dhe rritur koordinimin me ministrinë MMPH, MKRS DHE MAPL?	1. Gjatë periudhës raportuese <b>Janar - Shtator 2016</b> , komuna konkretisht Zyra për Integrim Evropian ka monitoruar zbatimin e PKZMSA –së, duke raportuar për periudhën janar – mars si dhe prill – qershor për zbatimin e veprimeve për komuna që dalin nga ky plan; Komuna e Prishtinës ka koordinim te vazhdueshëm me institucionet përkatëse;	
	7.3. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore	<b>Drejtoria e Kulturës</b>	1. A ka organizuar komuna e juaj vetë ndonjë fushatë për ndërgjegjësimin dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?	1. Gjatë periudhës raportuese <b>Janar - Shtator 2016</b> , komuna nuk ka organizuar asnjë fushatë për ndërgjegjësimin dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;	

## 2. BLOKU II - KRITERET EKONOMIKE

	<b>1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut</b>				
	1.1.Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes	<b>Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim te Qëndrueshëm Ekonomik</b>	1.Çfarë ka bërë komuna në zvogëlimin e mëtejshëm të barrierave në të bërit biznes me fokus në barrierat të cilat janë në kompetencë të komunave?	1. Komuna e Prishtines vazhdimisht mundohet per aq sa i përket te beje lehtësira per bërjen e biznesit. Vazhdimisht jemi ne kontakt me prodhuesit e produkte bujqesore per krijimin e hapësirave pa pagese per shitjen e produkteve te tyre – tregu mobil, panairi “blej shqip”, panairë të tjera gjatë vitit, promovimin e tyre dhe	

			<p>2.Sa është numri i bizneseve të regjistruara?</p> <p>3.Sa është numri i bizneseve të mbyllura?</p> <p>4. Sa ka ndarë buxhet komuna për subvencionimin e bizneseve?</p> <p>5.Sa janë funksionale Qendrat për promovimin e bizneseve?</p>	<p>subvencionimin e tyre;</p> <p>2. Sipas ligjeve në fuqi regjistrimi i bizneseve bëhet në Qendrën për regjistrim të bizneseve pranë MTI-së. Të gjitha të dhënat janë pranë kësaj qendre;</p> <p>3. Edhe mbyllja e bizneseve i nënshtrohet procedurave për të cilat është kompetente njësia e sipër cekur pranë MTI-së;</p> <p>4. Komuna e Prishtinës ka ndarë 80.000 EUR buxhet për përkrahjen e bizneseve të cilat mirën me eksportin e shërbimeve (BPO);</p> <p>5. Komuna është në përfundim të finalizimit të projektit të qendrës “Bussines HUB” i cili ka për qëllim promovimin e bizneseve në sferën e eksportit të shërbimeve (outsource);</p>	
1.2. Modernizimi i mbledhjes së të hyrave, për të reduktuar varësinë nga faturat doganore duke përmirësuar mbledhjen e tatimit në pronë dhe forcimin e kornizës ligjore për mbledhjen e tatimit dhe borxheve nga taksat	<b>Drejtoria e Pronës</b>	1. A është bërë modernizimi i mbledhjes së të hyrave në komunën tuaj, duke përmirësuar mbledhjen e tatimit në pronë?	1.Për mbledhjen e Tatimit në pronë, jemi duke e zbatuar, vjelja e detyruar e tatimit në pronë, gjithnjë, në bazë të nenit 18 Vjelje e detyruar e tatimit, të Ligjit <b>03/L-204</b> , dhe <b>UA 08/2011</b> , për vjeljen e tatimit në pronën e paluajtshme;		

komunale

2.Sa është forcuar korniza ligjore për mbledhjen e tatimit dhe borxheve nga taksat komunale?

3.Sa është përqindja e të hyrave të tatimit në pronë në të hyrat e përgjithshme të komunës? ( të raportohet në 6 mujorin e parë dhe të dytë të vitit)

2. Jemi duke zbatuar edhe kushtëzimet ndaj tatimpaguesve, në bazë të **UA 07/2011**, për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në pronë, si dhe Urdhëresën për kushtëzimet e shërbimeve komunale, me **01.nr.031-3109**, më **20.12.2011**;

Po ashtu jemi edhe duke realizuar edhe kampanjën për tatim në pronë, si dhe në bazë të kësaj kampanje mendojmë që do të jetë vetëdijesim për tatimpaguesit për kryerjen e obligimit ndaj Komunës;

Në bazë të aplikimit të këtyre Akteve si dhe kampanjës, është duke u realizuar mbledhja e tatimit në pronë;

2. Realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë për periudhën raportuese janar – shtator 2016 ka qenë:

Planifikimi 6,300,000.00 €

Realizimi 5,723,024.54 €



				Ne përqindje 90.84 %	
1.3.Procedurat e planifikimit të buxhetit nuk kanë qenë transparente dhe të koordinuar deri më tani. Programet e shpenzimeve të buxhetit nuk janë përputhur me prioritetet afat gjata të qeverisë.	<b>Drejtoria e Financave</b>	<p>1.Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?</p> <p>2. Cilat janë format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit në planifikimin e buxhetit?</p> <p>3.Çfarë veprime ka ndërmarrë komuna juaj për t'i përputhur programet e shpenzimeve të buxhetit me prioritetet afatgjata të qeverisë?</p>	<p>1 Gjatë periudhës raportuese janar – shtator 2016, numri i dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit është 8 (tetë);</p> <p>2. Parashihet që në dëgjimet publike të përfshihen të gjithë, qytetarët shoqëria civile si dhe grupet tjera të interesit;</p> <p>3. Gjatë periudhës raportuese janar – shtator 2016, komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim të tillë;</p>		
<b>2. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet</b>					
2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;	<b>Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim te Qëndrueshëm Ekonomik</b>	1. Sa është numri i inspektimeve me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal?	1. Në bazë të ligjit për qeverisje lokale Komuna e Prishtinës nuk ka kompetence te beje inspektime te tilla. Drejtoria e planifikimit nuk merret me asnjë lloj inspektimesh;		

			2.Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale?	2. Komuna nuk ka ndërmarr asnjë masë të tillë;	
	<b>3.Tregu i brendshëm</b>				
	3.1.Doganat dhe tatimet- Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik	<b>Drejtoria e Administratës</b>	1.A ka progres në modernizimin e administratës së brendshme të komunës suaj në platformën e IT-së dhe procedurave të saj?	1. Po ka progres, modernizimi i administratës së komunës në periudhën janar – qershor 2016 është realizua në këto pika: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistri i Procedurave Administrative,</li> <li>• Open Data,</li> <li>• E-Shpenzimet,</li> <li>• Votimi Digjital (Seancat e KK),</li> <li>• Senzorët për matjen e ndotjes së ajrit në Prishtinë,</li> <li>• E-Fatura (Printimi i faturës së tatimit në Pronë;</li> </ul>	

### 3. BLOKU III - STANDARDET EVROPIANE

	<b>1. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive</b>				
	1.1.Forcimi i kapaciteteve të stafit të one-stop shop	<b>Drejtoria e Administratës/Zyra e personelit</b>	1. Sa është numri i trajnimve të organizuara për stafin e one-stop shop në komunën tuaj?  2. Sa është numri i stafit të trajnuar në këtë fushë?	1. Gjatë periudhës raportuese janar – shtator 2016, Zyra e personelit nuk ka asnjë raport lidhur me organizimin e këtij lloji trajnimi;	

<p><b>2. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat</b></p>				
<p>2.1. Krijimi i mundësive për qytetarët e vendit që të shfrytëzojnë internet me shpejtësi 30 Mbps e më tepër</p>	<p><b>Zyra e IT-se</b></p>	<p>1. A ka shtrirjes të internetit në të gjitha institucionet publike ( p.sh. shkollat, ambulancat, zyrat e vendit etj)?</p>	<p>Gjatë muajve janar – shtator 2016 është bërë shtrirja e rrjetit kompjuterik në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Bashkësisive Lokale, por ende nuk janë të kyçura në internet.</p> <p>-Internet ka në të gjitha Shkollat e Komunës së Prishtinës;</p> <p>-</p>	
<p><b>3. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit</b></p>				
<p>3.1. Ngritja e cilësisë së rrugëve në rrjetin rrugor lokal</p>	<p><b>Drejtoria e Investimeve Kapitale/Sherbimeve Publike</b></p>	<p>1. Sa është përqindja aktuale e rrugëve lokale të shtruara në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është % aktuale e rrugëve të shtruara të Shenjëzuara, me trotuare, dhe të mirëmbajtura?</p>	<p>1. Nga 1296.87 km qe janë gjatësi e përgjithshme e rrugëve te Komunës se Prishtinës, 335.15km janë te ndërtuara. Kjo e bën 26% rruge lokale te shtruara ne Komunën tone;</p> <p>2. Përqindja e rrugëve te shtruara por njeherit edhe të sinjalizuara dhe të mirëmbajtura për sezonin veror dhe dimëror është rreth 36%;</p> <p>3. Gjatësia e rrugëve te shtruara me trotuare është 20%;</p> <p>4. Kurse gjatësia e rrugëve lokale te shenjëzuara është 36%;</p>	

	<b>4. Kapitulli 15 i Acquis-së: Energjia</b>				
4.1.Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe sigurisë bërthamore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike/Zyra e personelit</b>	1. A e posedon komuna juaj Planin për Efiqencë të Ebergjisë?  2.Sa është numri i trajnimeve të mbajtura për zyrtarët komunal për zbatimin e masave të dala nga Planet Komunale për Efiqencë të Energjisë?	1.Komuna e Prishtinës ka hartuar Planin Komunal për efiqencë të energjisë si dhe Planin e qëndrueshëm për efiqence – SEAP.  2. Gjate periudhës raportuese Janar-Shtator 2016 është mbajtur 1 trajnim për efiqencë – “Akademia për efiqence të energjisë”, ku janë trajnuar dy zyrtar komunal;		
4.2.Ka pasur përparim në planifikimin e efiqencës së energjisë në komuna, por nevojat e kapaciteteve lokale duhet forcuar	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike/Zyra e personelit</b>	1.Çfarë veprime ka ndërmarrë komuna për të forcuar kapacitetet lokale për planifikimin e efiqencës së energjisë?  2.Cilat janë aktivitetet konkrete për zbatimin e planit për efiqencë të energjisë?	1. Komuna e Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje me KFW për të rehabilituar 8 ndërtesa publike – shkolla energji efeciente ku do të investohen <b>1.151,087 euro</b> ne kuadër te kësaj shërbyesit civil te Komunës do te përfitojnë njohuri nga ekspertët e KFW te cilët do te ndihmojnë ne implementimin e këtij projekti;  2. Aktivitet konkret për zbatimin e këtij plani është ndriçimi publik me llampa led ne 104 rrugë të reja janë shtuar;		

<p><b>5. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjqësori dhe të drejtat themelore</b></p>				
<p>5.1.Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale</p>	<p><b>NJDNJK</b></p>	<p>1. Sa është numri i trajnimeve për zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave personale në komunën tuaj?</p> <p>2.A është funksionalizuar baza e të dhënave personale për zyrtarët komunal?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar- Shtator 2016 janë mbajtur 2 trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale;</p> <p>2. Te gjitha te dhënat e personelit janë futur ne sistemin informativ dhe menaxhues te burimeve njerëzore;</p>	
<p>5.2.Duhet siguruar që Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) dhe zyrat e vendit të plotësojnë kriteret e sigurisë për regjistrimin civil, por edhe kriteret e ruajtjes dhe mbajtjes së dokumenteve personale</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1.A është ngritur siguria fizike e dokumentacionit (roja fizike, vendosja e kamerave, grilat, kasafortat, etj.)?</p> <p>2. A mbahen librat fizik në komunën tuaj? Nëse jo, kur do fillohet të bëhet kjo?</p>	<p>1. Siguria fizike e dokumentacionit është në nivel, njëherit janë rojat dhe kamerat e vendosura;</p> <p>2. Në Komunën e Prishtinës mbahen librat fizik;</p>	
<p>5.3.Verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar, respektivisht tek gjendja civile në komuna, si dhe përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKK) dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1.Në Komunën tuaj, a bëhet verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar përmes Zyrës Komunale të Gjendjes Civile, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, si dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim?</p>	<p>1. Kërkesat e personave të riatdhesuar procedohen në Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR). Në Zyrën e Gjendjes Civile pajisen me dokumentet personale. Zyra i pranon kërkesat e tyre, dhe më pas i procedon në KKR ose KQR për vendimmarrje;</p>	

5.4.Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur

**Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale**

1.Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?

2.Sa është numri i shtëpive të rindërtuara për të rikthyerit?

3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?

4.Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?

5.Sa është numri i kurseve të gjuhës për fëmijët e riatdhesuar?

6.Sa është numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale?

1. Gjatë periudhës raportuese Janar- Shtator 2016, persona të riintegruar që janë regjistruar, lajmëruar në Zyre janë 445 raste. Ndërsa persona të zhvendosur nuk ka pasur;

2. Gjatë periudhës raportuese Janar- Shtator 2016, nuk ka pasur shtëpi të ndërtuar;

3.Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, për asistencë janë proceduar në Kryqin e Kuq 40 raste;

4. Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, kanë aplikuar për zhvillim të bizneseve 30 persona;

5.Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, ka pasur 2 raste për kurse gjuhe;

6.Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, janë referuar 12 raste për pajisje me dokumente personale dhe të njëjtin janë pajisur me dokumente;

--	--	--	--	--	--

<p>5.5.Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE dhe përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1. Sa është numri i personave të regjistruar nga komunitet RAE ?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të realizuara të regjistrimit falas?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, numri i personave të ri-regjistruar (kanë nxjerr dokumente të regjistrimit civil) nga komunitet RAE është 119;</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese Janar- Shtator 2016, është realizuar 1 (një) fushatë për regjistrimin falas;</p>	
<p><b>6. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria</b></p>				
<p>6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj?</p>	<p>1. Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së datës 27.05.2016 është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim ;</p>	
<p>6.2.Të përmirësohet siguria dokumenteve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit vendor</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1. A është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia?</p> <p>2. Sa zyrtar komunal janë certifikuar (që u janë nënshtruar testit të njohurive ligjore/procedurale dhe të sistemit)?</p>	<p>1. Jo ende nuk është përfunduar procesi i digjitalizimit te librave te gjendjes civile, kjo bëhet nga ARC-ja (Agjensioni i Regjistrimit Civil);</p> <p>2. Në komunën e Prishtinës i janë nënshtruar testit dhe janë certifikuar 41 zyrtar të Gjendjes Civile;</p>	
<p><b>7.Menaxhimi i Kufirit dhe Migracionit</b></p>				



<p>7.1.Puna dhe roli i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, (KKSBB), Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVSBB) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive</p>	<p><b>Zyra e Kryetarit</b></p>	<p>1.A janë funksionale Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ( KKSBB), Këshilli Lokal për Siguri Publike ( KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në komunën tuaj?</p> <p>2.Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSBB, KLSP dhe EVSB?</p> <p>3. Çfarë aktivitete kanë ndërmarrë për periudhën raportuese?</p>	<p>1. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i themeluar dhe funksional, Këshillat lokale për siguri ne komunitet janë 5 (pesë) dhe janë funksional, edhe ekipet vepruese janë funksionale;</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, është mbajtur 1 (një) takim dhe 2 (dy) tryeza te rrumbullakëta për luftimin e ekstremizmit;</p> <p>3. Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, Aktivitete kryesore mund të konsiderohet mbajtja e një tryeze të rrumbullakët për parandalimin e ekstremizmit te dhundshëm, KKSBB në bashkëpunim me KLSP, EVSB, MPB, Policia e Kosovës, Departamenti Amerikan i Drejtësisë ICITAP, KFOR-i, OSBE, qytetarë si dhe grupe tjera të interesit;</p>	
<p>7.2.Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve</p>	<p><b>Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit/Policia e Kosovës</b></p>	<p>1.Çfarë aktivitete konkrete janë ndërmarrë nga komuna, veprime që demonstrojnë përkushtimin për arritjen e rezultateve në luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve?</p>	<p>1.Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, DKA ka bërë trajnimin e mësimdhënësve për parandalimin e përdorimit të mjeteve të rrezikshme për shëndetin e nxënësve: duhanit, alkoolit dhe drogës. Gjithashtu, Aktiviteti I Komunës nëpërmjet KEPSH-it me qëllim te informimit të të rinjëve nga rreziku i drogës dhe parandalimi i saj</p>	

				ka qenë: shpërndarja e broshurave për prind dhe për adoleshent; (Informate shitesë nga DSHMS) Kemi mbajte dy trajnime per një pjese te stafit nga OJQ “Labyrinth”, dhe me pas disa aktivitete nëpër shkolla;	
	<b>8. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura</b>				
8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës		<b>Drejtoria e Administratës/ Zyra e IT</b>	1. A është pajisur me pajisje të teknologjisë informative 1 qendër burimore në Komunën e Prishtinës?	Komuna e Prishtinës ka pajisur shkollën fillore Model me te gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike duke ngritur kapacitetet teknike te arsimit gjithëpërfshirës;	
8.2.Zbatimi i planit të veprimit nga Strategjia ndërministrrore për shkollat promovuese të shëndetit 2009-2018		<b>Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit</b>	1. A keni zhvilluara materialet promovuese të shëndetit në komunën tuaj?	1. Materialet promovuese në Komunën tone janë te gatshme qe nga fundi i vitit 2015. Ne këtë material janë përfshire posterat dhe broshurat për 16 patologji me te cilat janë furnizuar te gjitha QMF-të. DKA në bashkëpunim me drejtorinë e Shëndetësisë kanë realizuar vizita sistematike nëpër shkolla për kontrollimin e nxënësve, për të siguruar një shëndet më të mirë. Po ashtu me disa shkolla dhe çerdhe është bere bashkëpunim qe ne baze te nevojave te behet vizite shëndetësore nga mjeku apo motra teknike të cilët e përcjellin gjendjen shëndetësore vazhdimisht.	

2. A janë ndërmarrë aktivitetet vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis?

Gjate muajit shkurt është botuar revista " Shëndeti 038" ne një tirazh te konsiderueshëm (por jo te mjaftueshëm) i cili po ashtu është shpërndare neper QMF- të e Komunës sonë. Revista publikohet çdo 6 muaj;

2.Aktivitete që janë ndërmarr nga Grupi I komunitetit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor gjatë periudhës Janar-Shtator 2016 janë :

- Shënimi i Ditës Botërore te Kancerit te Qafës së Mitrës. Aktivitetet janë realizuar në 3 fshatra të regjionit të Prishtinës ku janë mbajtur ligjërata, shpërndarë fletushka ,janë bërë pyetje të shumta, dhe këshilla;
- Java e Imunizimit – ne bashkëpunim me organizatat tjera aktiviteti është mbajtur ne QKMF për një jave rishtazi, njëkohësisht qytetaret janë pajisur me fletushka dhe material edukativo-informativ lidhur e rendësinë e imunizimit;

- |  |  |  |  |   |  |
|--|--|--|--|---|--|
|  |  |  |  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Shënimi i ditës se kancerit të prostatës;</li><li>• Dita Botërore e Luftës Kundër Duhanit – janë mbajtur ligjërata të shkurta për nxënësit e klasave të larta, aktiviteti ka vazhduar me biseda inter - aktive lidhur me këtë teme. Nxënësit po ashtu janë pajisur me broshura edukative, Aktiviteti ka qenë i përcjellur nga mediat ku edhe është realizuar emisioni edukativ i cili është emituar në ditët në vijim;</li><li>• Ligjëratat nëpër shkollë në baze të konkludimeve të nxjerra nga vizitat sistematike;</li></ul> |  |
|--|--|--|--|---|--|

<p>8.3.Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta</p>	<p><b>Drejtoria e Arsimit</b></p>	<p>1. A është zbatuar udhëzuesi për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësim-nxënie?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor?</p> <p>3. A është hartuar pakoja e materialeve për informimin e prindërve rreth rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe a është bërë shpjegimi i procedurave të regjistrimit?</p>	<p>1. Shumica e fëmijëve me nevoja të veçanta kanë planet individuale PIA dhe vlerësohen në bazë të PIA-së;</p> <p>2.Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor është: 32.</p> <p>3. Prindërit janë të informuar për procedurat e regjistrimit dhe rëndësisë së arsimit të tyre.</p>	
<p>8.4.Raportim se si i keni përmirësuar kushtet për cilësi dhe qasje në arsim për fëmijët me aftësi të veçanta, komunitetin pakicë, grupet e marginalizuara</p>	<p><b>Drejtoria e Arsimit</b></p>	<p>1. Çfarë veprime ka ndërmarrë komuna me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të veçanta, komunitetin pakicë, grupet e marginalizuara?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, komuna e Prishtinës ka ndërmarrë këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Është themeluar ekipi vlerësues komunal për fëmijë me nevoja të veçanta, i cili bënë vlerësimin e nxënësve në shkolla dhe është formuar në bazë të <b>UA 07/2012</b>.</li> <li>- sigurimi i mësimin në gjuhët e komuniteteve: serbe, boshnjake dhe</li> </ul>	

				<p>turke;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Mbështetja e komunitetit RAE si dhe FNV në arsimim dhe edukim, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë;</li> <li>-Organizimi i mësimin intensiv për të gjitha komunitetet;</li> <li>-Sigurimi i transportit për nxënësit të komuniteteve pakicë dhe fëmijëve me nevoja të veçanta nga vendbanimi deri në shkollë dhe anasjelltas;</li> </ul>	
8.5.Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit	<b>Drejtoria e Arsimit</b>	<p>1. Sa është numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë (në veçanti komunitet RAE)?</p> <p>2. Çfarë ka bërë komuna në parandalimin e braktisjes së shkollimit?</p>	<p>1. Në bazë të të dhënave gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator 2016, nuk ka pasur braktisje të shkollimit të komunitetin RAE;</p> <p>2. Drejtoria e Arsimit, ka plan veprimin për integrimin apo gjithëpërfshirjen e komunitetit RAE në sistemin e arsimit; Të gjitha shkollat organizojnë mësim plotësues në bazë të nevojave;</p>		
<b>9.Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi</b>					
9.1.Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	<p>1.A është hartuar plani për menaxhimin e mbeturinave komunale?</p>	<p>1. Plani për menaxhimin e mbeturinave është hartuar nga Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me GIZ-in. Ne kuadër të këtij plani është hartuar Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave si dhe Plani për koston operative;</p>		

<p>9.2.Ngritja e kapaciteteve administrative në nivelin lokal, për zbatimin e ligjit për mbeturina</p>	<p><b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b></p>	<p>1. Sa është numri i punëtorive të organizuara në komunën tuaj për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina?</p> <p>2. Sa është numri i stafit të trajnuar ?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2016, numri i punëtorive të organizuara në komunë për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina është 10 (dhjetë).</p> <p>2. Numri i stafit të trajnuar: 5 (pesë) punëtor;</p>	
<p>9.3.Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p><b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b></p>	<p>1. Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese janar-shtator, është mbajtur 1(një) fushatë vetëdijesimi për sistemin e menaxhimit të mbeturinave nëpër shkolla dhe institucione komunale, për ndarje të mbeturinave në të reciklueshme dhe mbeturina të përgjithshme;</p>	
<p>9.4.Përmirësimi i qasjes, cilësisë, qëndrueshmërisë financiare të performancës mjedisore të sektorit të menaxhimit të mbeturinave</p>	<p><b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b></p>	<p>1. A është përgatitur vlerësimi dhe plani reformues i sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta?</p> <p>2. A është përgatitur inventari për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes për mbeturina të rrezikshme?</p>	<p>1. Po. Plani reformues i sektorit për menaxhim të mbeturinave të ngurta është përgatitur nga Komuna duke përfshirë koston operative, kategorinë e klientëve dhe plani për caktimin e taksës për shërbimin e mbeturinave, të cilat janë në procedurën e miratimit në Kuvendin Komunal;</p> <p>2. Mbeturinat e rrezikshme janë obligim i nivelit qendror dhe çdo rekomandim që vjen për Komunën jemi të gatshëm ta kryejmë, për arsye se duhet të ketë impiante të veçantë me kushte specifike për trajtimin e tyre;</p>	

9.5.Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e ujërave nga veprimet e dëmshme	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	1.A është miratuar Programi i masave për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave?	1.Drejtoria e Infrastrukturës lokale, ka hartuar dhe implementuar Projekte të ujërave dhe trajtimit të shtratit të lumenjve dhe kolektorëve si Program Preventiv për mbrojtjen nga dëmet eventuale që i sjellin ujërat;		
9.6.Bashkërisht, financimi i investimeve dhe kapaciteti i komunave dhe operatorët për të zbatuar Ligjin për mbeturinat 2012 mbetet shumë i ulët	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	1. A ka participuar Komuna juaj në investimet e operatorëve me qëllim të zbatimit të Ligjit për mbeturina?	1. Komuna ka marrë pjesë në investimet e operatorit publik me blerjen e kontejnerëve për mbeturina;		
9.7.Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike/ Drejtoria e Inspektionit</b>	1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?	1. Numri i deponive ilegale në Komunën e Prishtinës ka qenë 65 deponi, për të cilat kemi organizuar 6 aksione për largimin dhe eliminimin e këtyre mbeturinave në këto deponi. Tani kemi të nënshkruar kontrate për eliminimin e deponive ilegale të cilat janë		



				eliminuar në tremujorin e tretë të këtij viti. Mandej kemi bere rehabilitimin e lokacionit në Barilevë qe ka sipërfaqe 4-5 hektarë qe ka qenë e mbuluar me mbeturina dhe tani është kthyer në hapësire të shfrytëzueshme;	
9.8.Ngritja e kapaciteteve institucionale për zbatim të legjislacionit në fushën e mjedisit	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike/Zyra e Personelit</b>	1. Sa zyrtarët mjedisor komunal janë trajnuar për legjislacion mjedisor?	1. Gjatë periudhës raportuese janar-Shtator 2016 është bërë trajnimi i 4 zyrtareve mjedisor për legjislacion mjedisor;		
9.9.Trajnimi i inspektorëve të nivelit qendror dhe lokal për zbatim të legjislacionit mjedisor	<b>Zyra e Personelit</b>	1.Sa është numri i punëtorive të mbajtura për zbatim të legjislacionit mjedisor?	1. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, Zyra e personelit nuk ka raporte që është mbajtur ndonjë punëtori e tillë;		
9.10.Ngritja e vetëdijes qytetarë për legjislacionin mjedisor	<b>Drejtoria e Arsimit</b>	1. A janë mbajtur ligjërata mjedisore me personel arsimor nxënës të niveleve VI-IX në shkolla?	1. Jo, ligjërata të veçanta nuk janë mbajtur. Mirëpo, ligjëratat dhe njohurit për mjedisin, nxënësit e këtij niveli arsimor i marrin në vazhdimësi nga ligjëratat e mësimdhënësve të po atij niveli;		
9.11.Edukimi mjedisor dhe vetedijësimi për mbrotjen e natyrës (Kopshti Botanik)	<b>Drejtoria e Arsimit/ Drejtoria e Bujqësisë</b>	1. Zgjedhja e lokacionit  2. Përgatitja e projektit zbatues			
<b>10.Bujqësia dhe peshkataria</b>					

	<p>10.1.Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore</p>	<p><b>Drejtoria e Inspektoratit/Drejtoria e Urbanizmit</b></p>	<p>1.Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore?</p> <p>2. Sa është numri i lejeve të lëshuara?</p> <p>3.Sa është numri i inspektimeve?</p> <p>4.Sa është numri i fletëparaqitjeve të parashtruara?</p>	<p>1. Numri i kërkesave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore për periudhën Janar - Shtator 2016 është 25;</p> <p>2.Për periudhën Janar - Shtator 2016, gjithsejt janë 166 leje të lëshuara: <i>85 leje ndërtimore (Kat.1=70 leje dhe Kat.2=62 leje) dhe 34 leje mjedisore;</i></p> <p>3. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, numri i inspektimeve është 0 (zero). Komuna e Prishtinës nuk ka inspektor qe mund te bej këtë lloj inspektimi. Si rezultat kjo duhet te ndryshohet ose te mos kërkohet përgjegjësi nga Komuna për çështjet te cilat nuk mund ti mbuloj ose ti ndihmohet komunës me kapacitete në mënyre qe komuna te mund te bej inspektimin;</p> <p>4. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, nuk është parashtruar asnjë fletëparaqitje;</p>	
	<p>10.2.Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)</p>	<p><b>Drejtoria e Bujqësisë</b></p>	<p>1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale?</p>	<p>1. Jo, komuna e Prishtinës ende nuk e posedon Planin për Menaxhimin e Tokave Rurale;</p>	

<p>10.3.Modernizimi i fermave bujqësore dhe ndërmarrjeve agropërpunuese përmes skemës së granteve, si dhe përmirësimi i kushteve për marketing</p>	<p><b>Drejtoria e Bujqësisë</b></p>	<p>1. Sa është numri i fermerëve dhe shoqatat e ujitjes të përkrahura nga MBPZHR?</p> <p>2. A ka pasur investime në ndërmarrjet agropërpunuese dhe në fermat bujqësore komerciale përmes granteve të MBPZHR?</p> <p>3. A ka pasur investime për diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve rurale?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, nuk kemi të dhëna për ndonjë fermerë dhe shoqata të ujitjes që janë përkrahur nga MBZHRP;</p> <p>2.Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, nuk ka pasur asnjë investim në ndërmarrjet agropërpunuese;</p> <p>3. Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, Komuna ka përkrahur direkt fermerët me subvencione prej 500.000 EUR;</p>	<p>Sa i përket pikës 1 dhe 2, ne si komunë nuk kemi ndonjë linjë të veçantë komunikimi që MPZHRP të na njoftoj se sa fermer nga komuna e jonë i ka përkrahur;</p>
<p><b>11.Zhvillimi Rajonal</b></p>				
<p>11.1.Pjesëmarrja e komunës në programet e BNK-së ( bashkëpunimit ndërkufitar)</p>	<p><b>Zyra e Kryetarit të komunës</b></p>	<p>1.Sa është numri i projekteve të BNK-së që komuna është pjesëmarrëse?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2016, komuna e Prishtinës nuk ka marrë pjesë në asnjë projekt të BNK-së;</p>	
<p>11.2.Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar</p>	<p><b>Zyra e Kryetarit të komunës</b></p>	<p>1.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal?</p> <p>2.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar?</p>	<p>1.Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016 Komuna ka nënshkruar , nuk kemi ndonjë marrëveshje të nënshkruar;</p> <p>2.Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2016, nuk kemi asnjë marrëveshje;</p>	

--	--	--	--	--	--